



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:247598  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05515880

C-IV-17-0293

Parashtruesi i ankesës; B Snga Fushë Kosova, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati H P, nga Prishtina.

E paditura; Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në li dhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi me datën;28.03.2024,merr këtë;

**A K T V E N D I M**

Ankesa e parashtruar nga B S nga Fushë Kosova konsiderohet e tërhjekur për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 05.01.2024, ka hartuar me shkrim vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për parashtruesin e ankesës duke e detyruar të njëjtin që pagesën ta kryej në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të kësaj vërejtje. Në shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i parashtruesit të ankesës e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me datën;15.01.2024, mirëpo edhe përkundër faktit të pranimit vërejtjes në shkresat e lëndës nuk është dëshmia se është kryer pagesa.

Arsyetimi ligjor;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke iu referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se i autorizuari i parashtruesit të ankesës edhe përkundër faktit që ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me datën:15.01.2024, nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin kohor prej 15 ditëve.

Andaj gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i ankesës mund të ushtroj ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimin të këtij aktvendimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi